



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbal i mbajtur më 15 prill 2014, në mbledhjen e III-të (tretë) të jashtëzakonshme Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, , Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullhau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica, ndërsa mungoi z. Islam Revuçë.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

Rendi i ditës

❖ Çështja e lokacionit për ndërtimin e obeliskut të heroit Afrim Zhitia

- z. Mehmet Gashi**, kryesues, e paraqiti fjalën hyrëse.
- z. Abaz Llugaliu**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, paraqiti sqarime për veprimet e ndërmarra lidhur me konstatimin e uzurpimeve në pjesën e lokacionit ku planifikohet ndërtimi i obeliskut.
- z. Fidan rekaliu**, theksoi, parafolësi sqaroi se Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, i ka nxjerr aktvendimet për konstatimin e uzurpimeve nga ana e personave përkatës dhe shtoi, ne duhet t'u përbahemi afateve për kontestimin e atyre aktvendimeve përkatësisht afatin e ankesës në mënyrë që të mos biem ndesh me ligjin.
- z. Rafet Llapashtica**, theksoi, u përmend se aktvendimet janë nxjerr më 08.04.2014 dhe se afati i ankesave ndaj aktvendimeve të cekura na obligon të presim 30 ditë sa është afati për parashtrimin e ankesës, andaj në aspektin ligjor duhet ta respektojmë këtë afat, mirëpo konsideroj se Drejtoria përkatëse është vonuar në nxjerrjen e atyre aktvendimeve.
- z. Kadri Avdiu**, theksoi, Drejtoria përkatëse e ka bërë punën e vet dhe me aktvendime ka konstatuar që persona konkret kanë uzurpuar pronë të komunës,

andaj unë jam i mendimit se KPF dhe Kuvendi duhet të jepin mendimin e vet lidhur me këtë çështje.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, ju njoftova se aktvendimet përkatëse janë nxjerr në bazë të një ligji i cili ka qenë në fuqi para luftës përkatësisht para vitit 1999, ngase për usurpime nuk është nxjerrë ligj i ri, mirëpo sipas rregullave juridike për t'u ekzekutuar një aktvendim ai duhet të jetë i plotfuqishëm, andaj duhet të presim vendosjen sipas ankesave të cilat do t'i shqyrtoi organi i shkallës së dytë.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga sqarimet e paraqitura del se ne jemi në fazën verifikimit se prona përkatëse a është pronë e Komunës apo e pretenduesve konkret, pra ende nuk jemi në fazën se kujt i destinohet ajo pronë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Drejtoria kompetente në bazë të dëshmive zyrtare ka konstatuar se në lokacionin përkatës është usurpuar një pjesë e pronës, mirëpo ne duhet të presim përfundimin e kësaj çështjeje sipas procedurave ligjore.

z. Haki Rudari, theksoi, në bazë të dëshmive që na u dorëzuan vërej se njëri petition është i datës 05.02.2014, ndërsa tjetri i datës 07.04.2014, kurse aktvendimi i Drejtorisë kompetente është i datës 08.04.2014 dhe në bazë të aktvendimeve po vërehet se gjendja në terren është në kundërshtim me ligjin, mirëpo pavarësisht nga kjo jam i mendimit se KPF duhet të merr ndonjë vendim konkret.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, parafolësi tha se KPF duhet të merr një vendim, mirëpo unë konsideroj se ne nuk mund të marrim asnjë vendim derisa çështja të vendoset në procedurën e ankesës, që parashtruesit e ankesës kanë afat 30 ditë dhe në momentin kur informohemi prej Drejtorisë përkatëse se aktvendimet janë të plotfuqishme, ne mund të miratojmë rekomandimin e vendimit konkret.

Në fund shtoi, e falënderoj Drejtorinë kompetente që ka ndërmarrë hapat procedural për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

z. Kadri Avdiu, theksoi, jam i mendimit se nuk ka vend për të falënderuar Drejtorinë përkatëse ngase këtë dokumentacion e ka vonuar shumë kur dihet se mospajtimet e para kanë filluar nga data 05.02.2014, andaj Drejtoria është dashur të filloj menjëherë procedurat përkatëse e të vërtetoj gjendjen faktike dhe sikur të vepronte menjëherë afati ligjor i ankesës do të ishte në muajin mars apo eventualisht në fillim të prillit 2014.

Për shkak të kësaj vonese ne duhet të presim që të vërtetohet se prona përkatëse është e Komunës, edhe pse kjo është e dëshmuar me argumente.

Tash përballemi me dy gjëra, e kemi një kërkesë apo të themi petition ku është Abdullah Çunaku, këtu nuk ka nënshkrim, e kjo është për çudi si mund të jetë i përmenduri përfaqësues i një lagjeje kur ai vet është usurpues i pronës së Komunës, për këtë jemi në dijeni të gjithë se për pronën e usurpuar ai nuk i nënshtronhet asnjë procedure e as ndonjë qiraje, pra shtrohet pyetja, si ai mund të jetë nënshkrues i një petitioni kur ai vet është usurpues, ngase të gjithë jemi në dijeni se ai e ka usurpuar objektin e postës në Lluzhan.

Mirëpo, ne duhet të bisedojmë se si të dalim nga kjo situatë mjaftë e ndjeshme, andaj konsideroj se duhet të bisedojmë në mënyrë të qetë dhe të dalim me një qëndrim konkret për veprimet e mëtutjeshme.

z. Naim Çunaku, theksoi, mbi bazën e asaj çka u tha nga parafolësit e në veçanti në diskutimin e z. Kadri Avdiut, rezulton se në lokacionin për të cilin po

debatojmë është një pjesë e sipërfaqes e usurpuar dhe shtoi, jam i interesuar të di se a ka sipërfaqe të lirë prej 34 ari sa është paraparë projekti për ngritjen e obeliskut.

Drejtori i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e përmendi se sot e kësaj dite usurpimet trajtohen me ligjin e vitit 1988, kjo na jep të kuptojmë se ne si shoqëri sa jemi të interesuar për kthimin e pronave të usurpuara.

E kam thënë më parë, po e them edhe në këtë rast se çështjen e usurpimeve mund ta prolongojmë edhe sot, dhe tash këtë çështje mund ta fusim nën tepih, por një ditë domosdo institucionet tona do duhet të merren me këtë çështje.

Përndryshe, edhe në mandatin e kaluar të Kuvendit e kam shprehur mendimin tim se do të ishte mirë që të inventarizohet prona e Komunës në gjithë territorin e saj, të shihet në çfarë gjendje është, të përcaktohen Komunat kadastrale ku pronat janë të usurpuara, pra Komuna duhet t'i qasët kësaj problematike, çoftë në mënyrë simbolike por që të filloj ky proces.

Në bazë të shkresave që na janë dorëzuar para mbledhjes del se është një afat ligjor i paraparë për animime në aktvendimet përkatëse dhe se në bazë të kësaj ne jemi një hapë drejtë zgjidhjes së këtij problemi, por faktikisht në aspektin kohor jemi larguar nga zgjidhja e këtij problemi.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, të gjitha diskutimet i konsideroj mjafë serioze dhe jam i bindur se qëllimi i të gjithë neve është që lidhur me këtë çështje të mos kemi ndasi, pra të jemi të përbashkët dhe mu për këtë qëllim është thirrur kjo mbledhje, kuptohet edhe për zgjidhjen e këtij problemi.

Materialet na u dorëzuan, jemi në dijeni për dispozitat ligjore, andaj konsideroj se do të pajtohem i që fillimisht të përfundojnë procedurat përkatësisht afatet ligjore, për çka do të na informoj drejtoria përkatëse e pastaj Ekzekutivi do t'i paraqes Kuvendit propozimin konkret për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nxjerrja e aktvendimeve nga Ekzekutivi, sipas mendimit tim, i shfuqizon dy peticionet e parashtruara ngase çështja ka filluar të vendoset në aspektin ligjor.

Kemi dy peticione, njëri është për ndërtimin e obeliskut ndërsa tjetri kundër, unë dyshoj se këto janë shkruar dhe nënshkruar nga një person, mirëpo siç e thash tani kjo nuk është me rëndësi ngase është iniciuar zgjidhja e çështjes në bazë të dispozitave ligjore, edhe pse është proces i vonuar, por ne duhet të respektojmë afatin e ankesës përkatësisht përgjigjen e organit të shkallës së dytë.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, z. Abdullah Çunaku në cilësinë e përfaqësuesit të fshatit Llugë, në vitin 2007, ka bërë kërkesë për ndarjen e lokacionit në sipërfaqe prej 4 ari për ngritjen e lapidarit për Afrim Zhituni, ndërsa tash i njëjti del kundër zgjerimit të sipërfaqes për ngritjen e obeliskut, gjithashtu nëse e shikojmë peticionin në vitin 2007 ka familje që kanë qenë për, e tash janë kundër, kjo është arsyaja që kësaj çështjeje duhet t'i qasemi me shumë seriozitet, ngase situata është shumë e acaruar dhe në bazë të kësaj do të jetë e vështirë që të ekzekutohen aktvendimet.

z. Kadri Avdiu, theksoi, drejtori tha se situata është shumë e acaruar dhe se aktvendimet e plotfuqishme do të jetë problem me i ekzekutuar, pra z. Abaz Llugaliu, po jep sinjale që edhe pas përfundimit të procedurës së animimit nuk do të mund të bëjmë asgjë, nga kjo del se ne po diskutojmë këtë.

Unë kam qenë në dijeni se Ekzekutivi i Komunës do të bëjë përpjekje që të shfrytëzoi çdo mundësim ligjore që kjo çështje të shtyhet dhe të mos realizohet.

z. Abaz Llugaliu, lidhur me diskutimin e parafolësit theksoi, unë thash se ekzekutimi i aktvendimeve do të paraqet problem e nuk thash se aktvendimet nuk do të ekzekutohen.

z. Haki Rudari, theksoi, në bazë të asaj çfarë u tha gjatë diskutimeve, vërehet se kjo çështje është prolonguar nga Drejtoria përkatëse, andaj unë shtroj pyetjen çka do të bëhet me rastet tjera nëse veprohet në këtë mënyrë, unë jam i mendimit e mund të them se është mendim edhe i subjektit politik të cilit i përkas por edhe i Grupit të këshilltarëve i LVV – së se gjërat duhet të vendosen në bazë të dispozitave ligjore dhe se nuk duhet të merren parasysh përçarjet e ndryshme ngase kushdo çoftë që e shkel ligjin ai duhet të bartë pasojat.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, jam i bindur se në parim të gjithë u pajtuam se duhet të presim përfundimin e procedurës së ankesës dhe se pas plotfuqishmërisë së aktvendimeve, Komiteti për Politikë dhe Financa mund ta shqyrtoj këtë çështje dhe Kuvendit t'i rekomandoj zgjidhje konkrete.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, jam i mendimit se në bazë të debatit të deritashëm jemi njohur më afërsisht me problematikën e kësaj çështjeje dhe shtoi, në momentin kur aktvendimet përkatëse bëhen të plotfuqishme, Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë do të përgatit materialin e nevojshëm në mënyrë që kjo çështje të iniciohet për shqyrtim në KPF përkatësisht në Kuvend.

Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.

Mbledhja përfundoi në orën 14.05'

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01- 006-50506
Podujevë,
15 prill 2014

Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi